



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr. 45, datë 31.07.2024

**PËR**

**MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË KUSHTEVE TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR  
OBJEKTIN: "GREEN COAST HOTEL 1, 2, 3, 4, 5, 6 KATE MBITOKË DHE 1 KAT  
NËNTOKË", ME VENDNDODHJE NË BASHKINË HIMARË**

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Green Coast" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rishikimit të kushteve të lejes së ndërtimit për objektin: "Green Coast Hotel 1, 2, 3, 4, 5, 6 kate mbitokë dhe 1 kat nëntokë", me vendndodhje në Bashkinë Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Green Coast" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhur Vendimit Nr. 24 datë 14.12.2022 "Leje Ndërtimi për objektin "Green Coast Hotel", zëvendësohen me Hartën e Planvendosjes si dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.



MINISTËR I/LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 14/02/2025